

**Kriteret e konkurimit dhe organizimi i Konkursit Kombëtar
“Legjendat Shqiptare në Novelat Grafike 4” 2018**

Pjesëmarrja:

- Konkursi është i hapur për të gjithë krijuesit, pa dallim moshe, gjinie, etj.
- Çdo pjesëmarrje në konkurs nënkupton pranimin e të gjitha kriterëve të shpallura.

Kriteret për realizimin e punimeve që do të paraqiten:

- Autorët mund ta paraqesin tekstin e punimit të tyre jo vetëm në shqipen standarde por edhe në dialekt.
- Nëse autori u përket pakicave kombëtare, ai mund ta paraqesë punimin në gjuhën e komunitetit të tij, por me përkthimin përkatës në gjuhën shqipe.
- Në punimet e paraqitura, duhet të respektohet Ligji i të Drejtave të Autorit, mos respektimi i të cilit sjell skualifikimin e punimeve të paraqitura.
- Teknika dhe forma e të shprehurit është e lirë.
- Të interesuarit duhet të paraqesin punimet e tyre në formatin digjital jpg ose pdf, në 3 fletë A4, me rezolucion 300 dpi, si dhe një CV personale në shqip, në format word ose pdf. me foto portret në format 4x5cm në jpg.

Koha e zhvillimit:

- Konkursi shpallet në muajin maj 2018.
- Konkursi do të mbyllet në datën 30 shtator 2018.

Mënyra e dorëzimit të punimeve:

- Kandidatët duhet t'i paraqesin punimet e tyre në mënyrë elektronike në adresën: novela.grafike.shqiptare@kultura.gov.al, brenda datës 30 shtator 2018.